

## ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij punimi të masterit ka qenë që studiohet dhe hulumtohet: *Politika ndëshkimore ndaj veprës penale të vjedhjeve të rëndë në territorin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës - dega në Vushtrri gjatë periudhës kohore 2017-2021*. Në këtë punim hulumtohet dhe trajtohet politika ndëshkimore ndaj vjedhjeve të rënda në fushën e legjislacionit penal dhe ndjekjes së kryesve si dhe në fushën e aplikimit të sanksioneve penale ndaj tyre. Studimi i politikës ndëshkimore ndaj vjedhjeve të rënda është me interes të posaçëm shoqëror, nga fakti se sot, në Kosovë, jemi dëshmitar se në mjetet e informimit publik pothuajse çdo ditë raportohen raste të vjedhjeve në shtëpi, banesë, qendra tregtare, banka, barnatore, vetura e të tjera. Ky lloj i kriminalitetit i ngulfat përpjekjet e qytetarëve që të sigurojnë një jetë më të mirë dhe më të sigurtë. Kjo nga fakti se me kryerjen e këtyre veprave penale të drejtuara kundër pasurisë qofshin ato klasike (vjedhja, vjedhja e rëndë, grabitja, vjedhja grabitqare) apo ato që kryhen tërthorazi, pra në mënyrë indirekte jo vetëm se çënohet pasuria e individit por në disa raste edhe jeta e tij. Veprat penale të vjedhjes së rëndë ishin prezente në masë të konsiderueshme gjatë periudhës së hulumtuar dhe kanë manifestuar pasoja të rënda për individin dhe interesat e tij pasurore.

Aktivitetet kriminale të kësaj natyre sot kryhen më shpejt dhe është më i vështirë zbulimi i kryesve, kjo për shkak të zhvillimit të hovshëm të teknikës, elektronikës, përsosjes së paisjeve kompjuterike, përsosjes së industrisë bashkëkohore e veçmas asaj automobilistike, telefonisë dhe teknikës më të sofistikuar. Në qoftë se flasim për shkaqet që e kanë nxitur këtë lloj të kriminalitetit në shoqërinë tonë, del se ato janë pothuajse çdoherë të natyrës ekonomiko-sociale. Në një shtet ku gjendja ekonomike është e rënduar, gjeneratat e reja në pamundësi që të gjejnë mjete dhe metoda të zhvillojnë një jetë normale, joshen pas dukurive negative dhe në të shumtën e rasteve kryejn vepra penale kundër pasurisë.

Gjatë realizimit të këtij punimi jam shërbyer me këto metoda shkencore:

- Metodën juridike- Përmes kësaj metode në mënyrë të qartë do të vërejmë saktësinë e përmbajtjes së normës juridike, kryesisht të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke u bërë interpretimi i tij në praktikën e Gjykatës Themelore të Mitrovicës- dega në Vushtrri me rastin e nxjerrjes së vendimeve gjyqësore për veprën penale të vjedhjes së rëndë.

- Metodën statistikore- Kjo metodë do të shërbejë për grumbullimin dhe pasqyrimin e të dhënave të cilat paraqiten përmes tabelave dhe grafikoneve në mënyrë vizuale. Ato ofrojnë mundësi që të kuptohen më lehtë cilësitë personale të kryesve të veprës penale të vjedhjes së rëndë siq janë: gjinia, mosha, përkatësia etnike, nivelin arsimor, statusin social, gjendjen pronësore.
- Metodën e mostrës- Përmes kësaj metode do të shqyrtojmë disa raste të cilat përfaqësojnë dukurinë në fjalë. Me metodën e mostrës do të vërejmë objektin, qëllimin dhe karakteristikat e shqiptimit të vendimit gjyqësor për kryesit e veprës penale të vjedhjes së rëndë.
- Metodën e studimit të rasteve individuale- Përmes kësaj metode në fokus do të jetë kryersi i veprës penale, vetitë dhe cilësitë e tij individuale, rrethanat e natyrës sociale dhe ato që kanë të bëjnë me ambientin. Kjo metodë ka për qëllim mbledhjen e të gjitha detajeve me rastin e nxjerrjes së vendimit gjyqësor për kryesit e veprës penale të vjedhjes së rëndë. Me rastin e analizimit të rasteve individuale do t'i vërejmë karakteristikat që e bëjnë të dalloj një rast nga rastet tjera në praktikën gjyqësore.

Fjalët kyçe:

- Politika ndëshkimore
- Vjedhja e rëndë
- Ndjekja e kryesve
- Sanksionimi